



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:173245

Datë: 16.12.2024

Numri i dokumentit: 06601295

C.nr.1588/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Afërdita Mulhaxha, në çështjen juridiko-civile të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), Sh,a, me seli në Pejë, të cilën e përfaqëson i autorizuari Granit Gërvalla, nga Peja, kundër të paditurit A.H., nga fshati Ll., Komuna e P., të cilin e përfaqëson Ahmet Rexhaj, avokat në Pejë, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 227.44€, në seancën e shqyrtimit kryesor, të mbajtur me dt.05.12.2024, në prezencën e të autorizuarit të palës paditëse dhe të paditurit, me dt.11.12.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), Sh,a, me seli në Pejë, me të cilën ka kërkuar që të: „ DETYROHET i padituri A.H., nga fshati Ll., Komuna e P., që paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), Sh,a, me seli në Pejë, në emër të kompensimit të dëmit t'i kompensoj shumën prej 227.44€, me kamatë ligjore, duke llogaritur nga dita e ngritjes së kësaj padie e deri në pagesën përfundimtare, si dhe t'i paguaj shpenzimet gjyqësore në shumë prej 20€, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

DETYROHET paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), Sh,a, me seli në Pejë, që të paditurit A.H., nga fshati Ll., Komuna e P., t'ia paguaj edhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 239€, e të gjitha këto në afat prej 15 dite, pas marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja, me padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, e nëpërmes të autorizuarit të saj, ka parashtruar se i padituri A.H., nga fshati Ll., Komuna e P., në vazhdimësi gjerë me dt.22.11.2014, në shtëpinë e tij, me qëllim që t'i sjell vetes pasuri në mënyrë të kundërligjshme, në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike, ashtu që komisioni profesional i KEDS, ka konstatuar se i padituri, në njësinë elektrik kishte manipuluar, duke shfrytëzuar energjinë elektrike pa matje, ku me këtë veprim, i padituri i ka shkaktuar paditëses dëm material, në shumë prej 277.44€.

Me tej ka theksuar se kjo vërtetohet me Aktgjykimin penal të Gjykatës Themelore në Pejë,, i plotfuqishëm me dt.04.05.2017, më të cilin i padituri A., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale ndryshim i njësinorit të shërbimeve, nga neni 323 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, përderisa pala e dëmtuar-paditësja, për realizimin e dëmit të shkaktuar, është udhëzuar në kontest civil, andaj i autorizuari i palës paditëse ka propozuar që gjykata pas administrimit të provave ta aprovoj kërkesëpadinë e paditëses në tërësi si të bazuar.

I autorizuari i paditëses, në fjalën e vetë përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, provave të bashkangjitura, duke potencuar se i padituri A., e

ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, e që është vërtetuar edhe me Aktgjykimin penal, ku pala paditëse është udhëzuar në kontest të rregullt civil, për realizimin e dëmit. Me tej ka theksuar se në bazë të faturës, të dt.26.12.2014, është vërtetuar se është shkaktuar dëmi, në vlerë prej 277.44€, andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi padinë dhe kërkesën e saj si të bazuar, si dhe të obligoi të paditurin ta paguaj taksën gjyqësore në shumë prej 20€.

I autorizuari i paditurit, në përgjigje në padi të dhënë me shkrim dhe gjatë shqyrtimit kryesor të dt.05.12.2024, ka theksuar se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar, për shkak të arritjes së parashkrimit të saj, për arsye së padia është paraqitur pas afatit të paraparë me nenin 341 të LMD-së. Me tej ka theksuar se i padituri me Aktgjykimin penal, e i cili është bërë i plotfuqishëm me dt.04.05.2014, është shpallur fajtor për veprën penale ndryshim i njësorit të shërbimeve, nga neni 323 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, kurse padia është dorëzuar në gjykatë me dt.09.12.2020, andaj ka ritheksuar se paditësja e ka lëshuar afatin ligjor për ta ushtruar më kohë padinë, bazuar në nenin 358 i LMD-së... duke cekur se është e çartë se paditësja padinë e ka ushtruar pas afatit, andaj konform nenit 357 par.1 të LPK-së, shihet çartë se paditësja nuk e ka shfrytëzuar kohën e caktuar me dispozitat ligjore në fuqi, për parashtrimin e kërkesës, ka propozuar që gjykata, padinë dhe kërkesën e saj t'a refuzoj si të pabazuar.

Në fjalën përfundimtare, ka ritheksuar se mbetet në tërësi pranë asaj, se në këtë çështje kontestimore ka ardhur deri të parashkrimi i kërkesëpadisë, dhe i njëjti i ka propozuar gjykatës që të refuzohet padia dhe kërkesën e saj si e pabazuar. Shpenzimet proceduare i ka kërkuar dhe atë: për përgjigje në padi shumë prej 104€, si dhe për një seancë të mbajtur shumë prej 135€, e në shumë të tërësishme shumë prej 239€.

Gjykata në këtë çështje juridike-kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, ka zhvilluar procedurën e provave ku u administruan si provë: Aktgjykimin penal, fatura e paditëses, për të paditurin A. e dt.26.12.2024.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku në lidhshmëri njëra me tjetrën, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i padituri A.H., nga fshati Ll., Komuna e P., në vazhdimësi gjerë me dt.22.11.2014, në shtëpinë e tij, në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike, ashtu qe komisioni profesional i paditëses, në procesverbalin me nr.0132969, ka konstatuar se i padituri A., njësorin elektrik e kishte manipuluar, se i njëjti ka shfrytëzuar energjinë elektrike pa matje, ku me këtë veprim i ka shkaktuar dëm materiale paditëses, në shumë prej 277.44€.

Kjo gjendje faktike është vërtetuar me prova që gjenden në shkresa të lëndës e të cilat u administruan në procedurën e provave, dhe atë: Aktgjykimin penal, i plotfuqishëm me dt.04.05.2017, dhe fatura e paditëses për të paditurin A. e dt.26.12.2014, nga të cilat kjo gjykatë ka vërtetuar edhe faktin se i padituri A., i ka shkaktuar dëm material paditëses, në shumë prej 277.44€.

Gjykata, gjatë vendosjes pati parasysh, provat e administruara dhe thëniet e të paditurit se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 357 par.1 dhe 362 par.3, të Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr. 04/ L-077 të Kosovës (LMD-së), ka arritur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e pabazuar.

Sipas nenit 357. paragraf 1, të LMD-së Nr. 04/ L-077 të Kosovës, parashihet se kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite, nga data kur i dëmtuari ka marrë djeni për dëmin dhe për personin i cili e ka shkaktuar dëmin.

Sipas dispozitave të nenit 362. paragraf 3, të LMD-së Nr. 04/ L-077 të Kosovës, kërkesat e siguruesit nga kontratat e sigurimit parashkruhen për tre (3) vjet.

Duke ju referuar dispozitave ligjor të lartcekura, pretendimeve të palëve, dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, rezulton se kemi të bëjmë me çështje e cila është parashkruar.

Në bazë të provave të lartcekura, gjykata ka konstatuar se paditësja ka ra në vonesë, për të kërkuar kompensimin e dëmit, meqenëse aktgjykimi më të cilin i padituri është shpallë fajtor për veprën penale ndryshim i njësorit të shërbimeve, nga neni 323 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, është shpallë me dt.05.04.2017 dhe është bërë i plotfuqishëm me dt.04.05.2017, ndërsa *padia lëndore* për të kërkuar kompensimin e dëmit ndaj të paditurit është parashtruar në gjykatë me dt.09.12.2020, çka do të thotë se pala paditëse në rastin konkret e ka humbur të drejtën që të kërkojë përmbushjen e detyrimit në procedurë gjyqësore, sepse kërkesa e saj është parashkruar në kuptim të dispozitave të lartcekura, *(për faktin se nga momenti i shpallës së Aktgjykimit penal e deri te paraqitja e padisë në gjykatë, nga ana e palës paditëse, ka kaluar afati i paraparë ligjor prej tri (3) viteve).*

Gjykata, me rastin e vendosjes pati parasysh edhe pretendimet e palës paditëse në kuptim të pretendimeve nga padia, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për arsye se në rastin konkret me provat në shkresa të lëndës dhe me kërkesën e të paditurit është vërtetuar fakti se kërkesa e palës paditëse është parashkruar, në kuptim të dispozitave të cekura më lartë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mori konform nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-së, ashtu që paditësja është obliguar që të paditurit t'ia paguajë shumën e tërësishëm prej 239€, dhe atë: për përpilim të përgjigjes në padi, shumën prej 104€, dhe për një (1) seancë gjyqësore të mbajtur, shumën prej 135€.

Bazuar në arsyet e dhëna u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË, C.nr.1588/20, me dt.11.12.2024.

G j y q t a r j a
Afërdita Mulhaxha

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet të kësaj gjykate.